REPUBLIKA E KOSOVËS * REPUBLIKA KOSOVA
KOSOVA CUMHURİYETİ
Komuna e Prizrenit * Opština Prizren
Prizren Belediyesi
Kryetari i Komunës Predsednik Opštine
Belediye Başkanı

01 Nr. 487/25 Dt. 07.08.2025

**Republika e Kosovës**
**Republika Kosova- Kosova Cumhuriyeti**

**Komuna e Prizrenit**
**Opština Prizren – Prizren Belediyesi**

# Procesverbali për Projekt-Planin e Veprimit për Transparencë Komunale 2025-2028

Konsultimi publik me qytetarë është organizuar nga grupi punues për hartimin e Plotësim-Ndryshimin e Rregullores për mbikëqyrjen, menaxhimin dhe shfrytëzimin e objekteve publike sportive dhe kulturore. Njoftimet për qytetarë për organizimin e konsultimit publik janë bërë në përputhje me legjislacionin në fuqi.

**-Me 002.06.2025**, kryetari i Komunës, Shaqir Totaj ka formuar grupin punues për Hartimi e Projekt-Planin e Veprimit për Transparencë Komunale 2025-2028. Anëtarët e këtij grupi janë:

Ymer Berisha, kryesues; Eleonora Fetollari-Bush, anëtare; Eroll Shabani, anëtar (EcMaNdryshe); Adelina Hoxha, anëtare; Adonita Karavidaj, anëtare; Naim Kukaj, anëtar; Haziz Krasniqi, anëtar; Fisnik Minci, anëtar; Adem Kollari, anëtar (OSCE); Adnan Korejshi, anëta; Alban Susuri, anëtar.

**Publikimet:**

Publikimet janë bërë me **29.07.2025** në webfaqe zyrtare të komunës, në facebook-un e komunës, si dhe në platformën e konsultimeve publike:

Në webfaqe:

https://prizren.rks-gov.net/wp-content/uploads/2025/07/Projekt-Plani-i-Veprimit-per-Transparence-komunale.pdf

Në platformë:

https://konsultimet.rks-gov.net/viewConsult.php?ConsultationID=42884

Njoftimi si lajm në webfaqe:

https://prizren.rks-gov.net/news/njoftim-per-organizimin-e-konsultimit-publik-per-projekt-planit-te-veprimit-per-transparence-komunale-2025-2028/

Në facebook:

https://www.facebook.com/share/p/16mnUq5o56/

**Me 29.07.2025**, njoftimi dhe plani (në tri gjuhë) u është dërguar përmes emailit, qytetarëve, klubet sportive, OJQ, organizata të ndryshme, drejtor të shkollave, bizneseve, organizatat studentore, ekspert të fushave, mediat lokale, shoqatave të ndryshme si dhe organizata rinore, që të kenë mundësi të njihen më detajshëm me dokumentin në fjalë, sepse disa nga ta nuk kishin pasur mundësi ta lexonin të publikuar në ueb faqe.

**Me 07.08.2025**, është mbajtur konsultimi publik, vegëza e publikimit të lajmit për mbajtjen e konsultimit:

Në webfaqe:

https://prizren.rks-gov.net/news/u-mbajt-konsultim-publik-me-qytetare-per-projekt-planin-e-veprimit-per-transparence-komunale-2025-2028/

**Konsultimi ka filluar në orën 10:15**

Ymer Berisha, udhëheqës i Njësisë për Komunikim me Publikun tha se edhe ky dokument do të ketë bashkautorësinë me qytetarët dhe nga qytetarët presim kërkesa, komente, ide dhe sugjerime në mënyrë që ky dokument të jetë sa më përmbajtjesore, profesional dhe lehtë i zbatueshëm.

Për mbajtjen e këtij konsultimi, zyrtarët përgjegjës do të mbajnë shënime dhe do të hartojnë procesverbal dhe më pas edhe raport për gjithë ecurinë e këtij procesi, të dy dokumentet do të publikohen në webfaqen zyrtare të komunës, në mënyrë që të kemi memorie institucionale dhe kurdo që qytetari ka dëshirë të dijë se çka është është kërkuar në këtë konsultim mund ti çaset webfaqes dhe të gjej dokumentin zyrtar.

Kerkesat e qytetarëve të parashtruara gjatë mbajtjes së konsultimit publik me qytetarë:

**Bashkim Gashi**

Sigurisht konsultimi publik është qe me dhëne ide qysh me plotësua atë pune. Nëse ia lëshojmë një sy projektit me te gjitha ato kushtet ligjore duke u nis me ligjet qe janë ne fuqi janë plotësua, pse e them ketë përderisa prej GAP-it ka dal 100% atëherë do te thotë s'duhet me bo kurgjo, sigurisht qe duhet te behet ne mënyrë qe te përmirësohemi.

Vite me radhe komuna e Prizrenit ka arrit piken e dëshirueshme ne lëmine e transparencës, vitin e ardhshme duhet te shtohen me vullnetin e mire te kuvendit, kuvendareve etj. Ajo qe mka ra ne sy është besoj qe është dashtë me be fjale për transparencën e planit te veprimit ne fusha te ndryshme, ne këto plane parashihet nifar komisioni i cili ka me be nifar monitorimi te këtyre.

Mendoj qe nëse dojme me zhvillu transparencën besoj qe është e pakte njëherë ne vit dhe duhet te njoftohet edhe opinion. Me mledh grupe te interesuarve te cilët janë me pa çka është bere dhe këto plane mos me qene statike.

Dokument te cilat i prodhon komuna duhet te jene presive me aktivitete po edhe ne baze te mundësive financiare qe i ka, shpeshherë na ka ra me pa qe thajnë që nuk kemi pare se kjo u kane mire kur e kanë aprovua.

Besoj ne hartimin e këtyre dokumenteve, mirëpo ne grupe me te ngushta shkon një zyrtare, bisedon me 2 a 3 persona, bisedojnë, i marrin kërkesat dhe opinion njoftohet, kjo kishte me qene përtej atyre qe komuna e Prizrenit i ka bere deri tash.

**Defrim Thaqi-Caparc**

Deshta veç me thane se duhet me ardhur të gjithë ne konsultime publike ne mënyrë qe te informohen me shume.

**Agron Halimaj-Poslishte**

Ne si kryetare te bashkësive lokale duhet me qene me te informuar nga ana e komunës për punët qe bëhen.

**Konsultimi ka përfunduar në orën 10:40.**

Linku i mbajtjes së konsultimit: https://www.facebook.com/share/v/1AyRY31qDi/

Procesmbajtës/e:

Adelina Hoxhaj

Haziz Krasniqi

Republika e Kosovës
Republika Kosova- Kosova Cumhuriyeti

Komuna e Prizrenit
Opština Prizren – Prizren Belediyesi

Lista e nënshkrimeve e **qytetarëve** pjesëmarrës në konsultimin publik për: Projekt-Planin të Veprimit për Transparencë Komunale 2025-2028

**Emaili dhe numri i telefonit do të përdoren për t'ju dërguar njoftime-ftesa për organizimin e konsultimeve, takimeve dhe dëgjimeve publike.**

Data e mbajtjes së konsultimit: **07.08.2025**. 10:15 – 10:40

| Nr. | Emri | Mbiemri | Nr.Tel | Email | Gjinia | Nënshkrimi |
|---|---|---|---|---|---|---|
| 1 | Qazimi | Thaçi | [redacted] | [redacted] | M | |
| 2 | Adelina | Hoxhaj | -//- | -//- | F | |
| 3 | AGRON | HALIMAJ | [redacted] | -//- | M | |
| 4 | BEKIM | THAQI | [redacted] | ——— | M | |
| 5 | AFRIM | TESECI | ——— | | | |
| 6 | Vjollca | Gurguriq | [redacted] | [redacted] | F | |
| 7 | Qeon. | Selmi | [redacted] | [redacted] | F | |
| 8 | Sahit | Bytyqi | [redacted] | [redacted] | M | |
| 9 | HAMDI | BILURDAGI | [redacted] | [redacted] | M | |
| 10 | BASAKIM | GASHI | [redacted] | [redacted] | M | |
| 11 | | | | | | |
| 12 | | | | | | |
| 13 | | | | | | |
| 14 | | | | | | |
| 15 | | | | | | |